

ILIRIAN MARTIRI

**FAKTORË IMEDIATË QË VIHEN RE NË RAPORTET
SEMANTIKO-SINTAKSORE GJATË PËRDORIMIT
LIGJËRIMOR NË MEDIAN ELEKTRONIKE**

Lidhur me Kuadrin e Përgjithshëm Gjuhësor, duhet vënë në dukje se në vitet '70 të shekullit XX dolën qartë ndërlikimet e marrëdhënieve ndërmjet gjuhës dhe logjikës, sidomos në sintaksë e semantikë, duke pasur parasysh se elemente si theksi, intonacioni, apo edhe disa rregulla sintaksore mund të shpjegohen qartë vetëm duke iu referuar faktorëve jashtësintaksorë, madje edhe jashtëgjuhësorë, pa lënë mënjanë faktin se konteksti i përdoruesit lidhet me folësin dhe dëgjuesin si motorët e parë të gjithë sipërmarrjes gjuhësore, vështruar në aspektin teorik (orientimi gramatikor), por edhe në atë praktik (lidhja me përdorimin).

Në literaturën teorike të këtyre viteve spikat orientimi në fushën e pragmatikës gjuhësore, e cila studion marrëdhëniet ndërmjet gjuhës dhe atij që e përdor, marrëdhëniet ndërmjet mesazhit me përdoruesit e gjuhës, pa harruar faktin se pragmatika është një disiplinë që sheh si përdoret gjuha nga njerëzit realë për qëllimet e tyre dhe brenda caqeve të rrokjes së tyre.

Gjithashtu, pragmatika gjuhësore interesohet për marrëdhëniet mes elementeve të strukturës së gjuhës, si dhe për parimet e përdorimit të saj. Ajo rrok ato aspekte të marrëdhënieve ndërmjet gjuhës dhe kontekstit, që kanë vlerë për hartimin e gramatikave. Sipas Stephen Levinson-it¹, pragmatika mund të quhet edhe studimi i gjuhës nga pikëpamja funksionale.

Ndërkohë që **gramatika sheh se si e marrin kuptimin format gjuhësore pavarësisht nga konteksti**, sipas teorisë së Çomskit, pragmatika do të ishte ajo që ai e quan ekzekutim (performancë) dhe jo kompetenca (dija e gjuhës dhe e rregullave të saj që janë në psikikën tonë).

¹ S. C. Levinson, *Pragmatics*, Cambridge, 1983.

Rrjedhimisht, pragmatika përqendrohet te përdoruesit e gjuhës dhe te kushtet e tyre të përdorimit të gjuhës, duke i parë këto të fundit si të përcaktuara nga konteksti i shoqërisë. Nga njëra anë, janë gjuhësore dijet e ngulitura në semantikën e gjuhës, ndërkohë që pragmatike janë qëllimet praktike, nga të cilat drejtohet përdorimi i dijeve jogjuhësore në bashkim me dijet gjuhësore.

R. Schank, L. Birnbaum, J. Mey, në artikullin e tyre “Integrated Semantics and Pragmatics” (1985) argumentojnë se ka një unitet funksional mes tyre: semantika është pjesë e pragmatikës, pra, e dijeve tona për botën dhe përdorimin e gjuhës. Gjithashtu, këta autorë janë të mendimit se të kuptuarit arrihet duke bashkuar zbatimin e dijeve semantike e pragmatike. Së bashku këto dy anë përbëjnë nivelin konceptual.

Gjatë komunikimit arrihet të merret një kuptim, por nxjerrja e përfundimit luan rol qendror në të kuptuarit e gjuhës. Kjo arrihet nëpërmjet asaj që dëgjohet, nëpërmjet asaj që nënkuptohet vazhdimisht. Teoria pragmatike ndihmon për të kapërcyer hendekun ndërmjet asaj që thuhet dhe asaj që synohet e kuptohet, por edhe për të parë çfarë interpretimi kanë fjalitë në kontekstet e ndryshme.

Në një perspektivë më specifike, gramatikat janë teori për strukturat e tipave të fjalive, ndërkohë që semantika studion kuptimin e këtyre fjalive, duke pasur parasysh këtu se fjalia është një tërësi e përcaktuar brenda një teorie gramatikore, ndërsa thënia është një pjesë, një tërësi që del ose është e ngjashme me fjalinë, por brenda një konteksti të aktualizuar, duke shtuar gjithashtu se thënia mund të jetë edhe një fjali e lidhur me një kontekst.

Semantika merret me kushtet e vërtetësisë që u jepen formulimeve të ndërtuara drejt, ndërkohë që pragmatika merret me kushtet e përshtatshmërisë që u jepen po atij kompleti fjalish me interpretimet e tyre semantike. Gjithashtu, pragmatika duhet të parashikojë kompletin e konteksteve, në të cilat ajo (fjalia) do të ishte e përshtatshme dhe do të kishte kuptimin e saj.

Në këtë perspektivë, duhet theksuar gjithashtu se semantika nuk mund të barazohet me logjikën, pasi vetë semantika është studimi i marrëdhënieve të shenjave me objektet për të cilat zbatohen shenjat. Për më tepër, semantika studion kuptimin e fjalive, merret me kuptimin jashtë kontekstit, me kushtet e vërtetësisë që u jepen formulimeve të ndërtuara drejt, ndërkohë që nga ana e saj, teoria pragmatike ndihmon për të kapërcyer hendekun ndërmjet asaj që thuhet dhe asaj që synohet e kuptohet, për të parë çfarë interpretimi kanë fjalitë në kontekstet e

ndryshme. Kjo bëhet për arsye se gjatë komunikimit përftohet një kuptim, por nxjerrja e përfundimit luan rol qendror në të kuptuarit e gjuhës, duke u realizuar nëpërmjet asaj që kapet nëpërmjet dëgjimit, nëpërmjet asaj që nënkuptohet vazhdimisht.

Kështu, duke kaluar në shqyrtimin e disa shembujve të vjelë nga media elektronike, vihen re elemente semantiko-kuptimore të shprehura nëpërmjet kategorive sintaksore, duke nxjerrë në pah funksionalitetin e tyre në ligjërim:

INDIVIDI / PSIKIKA:

- **Veçori psikike / psikologjike** shprehur me **rrethanor mënyre:**
- **Perceptim** shprehur me **fjali të nënrenditur kundrinore, së cilës i nënrenditet një fjali përcaktore:**

I rritur ndërmjet revolucionit teknologjik dhe fermentit politik dhe kulturor që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh *me zhgënjim* ndaj kompanive të Internetit: *një botë “liberale” në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste.* (ATSH, 02.05.2017).

- **Kujtesë** shprehur nëpërmjet **kallëzuesit:**

Kujtoni ditët pas Europeanit, kur disa qytete u grindën mes tyre, sepse donin të ishin të parët për ta graduar “Nderi i qytetit” pikërisht Pinokun, që talentin më të madh e tregon kur çnderon futbollin më shumë se kur e nderon atë... (Panorama Sport, 02.06.2017).

JETA / KOHA:

- **Jetësore** shprehur me **kundrinor të drejtë:**

Kreditorët, me Gjermaninë nga njëra anë dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar nga ana tjetër, deri tani kanë bllokuar *lëvrimin* e kështit të fundit, në mes të një marrëveshjeje nëse duhet apo jo të lehtësohet shlyerja e borxheve për Greqinë në një nivel të qëndrueshëm. (Shqiptarja.com, 10.06.2017).

- **Maturim** shprehur me **fjali të nënrenditur mënyrore:**
- **Kohë** shprehur me **fjali të nënrenditur përcaktore:**

(1) *I rritur ndërmjet revolucionit teknologjik dhe fermentit politik dhe kulturor* (2) *që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh me zhgënjim ndaj kompanive të Internetit: një botë “liberale” në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste.* (ATSH, 02.05.2017).

- **Kohë** shprehur nëpërmjet **kundrinorit të drejtë:**

Kujtoni ditët pas Europeanit, kur disa qytete u grindën mes tyre, sepse donin të ishin të parët për ta graduar “Nderi i qytetit” pikërisht Pinokun, që talentin më të madh e tregon kur çnderon futbollin më shumë se kur e nderon atë... (Panorama Sport, 02.06.2017).

- **Periudhë historike** shprehur nëpërmjet **rrethanorit të kohës:**

Kisha është ndërtuar *gjatë periudhës* së kalimit nga shek. XI në shek. XII dhe më vonë ky objekt kaq unik në vendin tonë u është nënshtruar disa ndërhyrjeve të reja restauruese... (ATSH, 03.06.2017).

VENDI:

- **Natyre** e shprehur nëpërmjet **kundrinorit të drejtë:**
- **Shtrirje** shprehur nëpërmjet **rrethanorit të mënyrës:**

“Zero yje” është emri i hotelit me zero mure, që të jep mundësinë që të shikosh (1) *malet e qiellin* (2) *pa asnjë lloj pengese*. (Shqiptarja.com, 08.06.2017).

- **Sfond** i shprehur nëpërmjet **rrethanorit të vendit:**
- **Mjedis** i shprehur nëpërmjet **kallëzuesit emëror:**
- **Vend** i shprehur nëpërmjet **kallëzuesit emëror:**
- **Vend** i shprehur nëpërmjet **rrethanorit të vendit:**

(1)*Para togave të zeza*, të katër dëshmitarët pohuan faktin se ditën kur ka ndodhur rrëmbimi dhe vrasja e Gaz Çollakut, i ndjeri Ervin Dalipaj, i akuzuar për këtë ngjarje, (2,3) *ishte me ta* (3,4) *në një lokal në Tiranë*. (Shekulli, 09.06.2017).

- **Vend** i shprehur nëpërmjet **rrethanorit të vendit:**

Kisha është ndërtuar *gjatë periudhës* së kalimit nga shek. XI në shek. XII dhe më vonë ky objekt kaq unik *në vendin tonë* u është nënshtruar disa ndërhyrjeve të reja restauruese... (ATSH, 03.06.2017).

- **Pozicionim** i shprehur nëpërmjet **kryefjalës:**

Kreditorët, me Gjermaninë nga njëra anë dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar nga ana tjetër, deri tani kanë bllokuar lëvrimin e këstit të fundit, në mes të një marrëveshjeje nëse duhet apo jo të lehtësohet shlyerja e borxheve për Greqinë në një nivel të qëndrueshëm. (Shqiptarja.com, 10.06.2017).

- **Pozicionim** i shprehur nëpërmjet **kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë:**

Kreditorët, me Gjermaninë nga njëra anë dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar nga ana tjetër, deri tani kanë bllokuar lëvrimin e këstit të fundit, në mes të një marrëveshjeje nëse duhet apo jo të lehtësohet shlyerja e borxheve për Greqinë në një nivel të qëndrueshëm. (Shqiptarja.com, 10.06.2017).

I rritur *ndërmjet revolucionit* teknologjik dhe *fermentit* politik dhe kulturor që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh me zhgënjim ndaj kompanive të Internetit: një botë “liberale” në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste. (ATSH, 02.05.2017).

- **Pozicionim** i shprehur me **fjali të nënrenditur përcaktore**:

...një qeveri vepruese në realen tonë, *që e kemi në vend*, që e avancon gjendjen në rend dhe ligj, që e avancon menjëherë gjendjen në ekonomi, duke u bazuar në sipërmarrësit tanë... (Shekulli, 09.06.2017).

- **Sfond** i shprehur nëpërmjet **raporteve kushtore**:

Kreditorët, me Gjermaninë nga njëra anë dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar nga ana tjetër, deri tani kanë bllokuar lëvrimin e kështit të fundit, *në mes të një marrëveshjeje nëse duhet apo jo të lehtësohet shlyerja e borxheve* për Greqinë në një nivel të qëndrueshëm. (Shqiptarja.com, 10.06.2017).

- **Sfond** i shprehur me **fjali të nënrenditur përcaktore**:

Ata humbën mbi dhjetë vende në Parlament, krahasuar me parlamentin paraardhës, *ku, mes humbësve, ishin edhe pesë ministra të qeverisë May*, të cilët nuk arritën të mbanin vendin e tyre në Parlament. (Shekulli, 09.06.17).

INSTITUCIONET:

- **Shoqëria** e shprehur me **kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë (togje)**:

I rritur ndërmjet *revolucionit teknologjik dhe fermentit politik dhe kulturor* që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh me zhgënjim ndaj kompanive të Internetit: një botë “liberale” në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste. (ATSH, 02.05.2017).

- **Kultura** e shprehur nëpërmjet **përcaktorit me përshtatje**:

I rritur ndërmjet *revolucionit teknologjik dhe fermentit politik dhe kulturor* që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh me zhgënjim ndaj kompanive të Internetit: një botë “liberale” në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste. (ATSH, 02.05.2017).

- **Ekonomia** e shprehur me **kundrinor të zhdrejtë me parafjalë**:

- **Shoqëria** e shprehur me **kundrinor të zhdrejtë me parafjalë**:

- **Politika** e shprehur me **kundrinor të zhdrejtë me parafjalë**:

...një qeveri vepruese në realen tonë, që e kemi në vend, që e avancon gjendjen në rend dhe ligj, që e avancon menjëherë gjendjen *në ekonomi*, duke u bazuar në sipërmarrësit tanë... (Shekulli, 09.06.2017).

- **Politika** e shprehur nëpërmjet **përcaktorit me përshtatje**:

I rritur ndërmjet *revolucionit teknologjik dhe fermentit politik dhe kulturor* që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh me zhgënjim ndaj kompanive të Internetit: një botë “liberale” në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste. (ATSH, 02.05.2017).

- **Shumica** e shprehur me **kryefjalë**:

- **Shumica** e shprehur me **përcaktor me drejtim:**
- **Shumica** e shprehur me **fjali të nënrenditur kundrinore:**

I rritur ndërmjet revolucionit teknologjik dhe fermentit politik dhe kulturor që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh me zhgënjim ndaj kompanive të Internetit: (1) një botë “liberale” në sytë (2) e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste. (ATSH, 02.05.2017).

- **Institucion** i shprehur nëpërmjet **rrethanorit të vendit:**

Ata humbën mbi dhjetë vende në *Parlament*, krahasuar me parlamentin paraardhës, ku, mes humbësve, ishin edhe pesë ministra të qeverisë May, të cilët nuk arritën të mbanin vendin e tyre në Parlament. (Shekulli, 09.06.17).

- **Ndikim** i shprehur nëpërmjet **kallëzuesit:**

Kisha është ndërtuar gjatë periudhës së kalimit nga shek. XI në shek. XII dhe më vonë ky objekt kaq unik në vendin tonë u është nënshtruar disa ndërhyrjeve të reja restauruese... (ATSH, 03.06.2017).

FUNKSIONIMI:

- **Ngjarje** e shprehur nëpërmjet **kryefjalëve:**

Para togave të zeza, të katër dëshmitarët pohuan faktin se ditën kur ka ndodhur *rrëmbimi dhe vrasja* e Gaz Çollakut, i ndjeri Ervin Dalipaj, i akuzuar për këtë ngjarje, ishte me ta në një lokal në Tiranë. (Shekulli, 09.06.2017).

- **Ngjarje** e shprehur nëpërmjet **rrethanorit të kohës:**

Kujtoni ditët *pas Europeanit*, kur disa qytete u grindën mes tyre, sepse donin të ishin të parët për ta graduar “Nderi i qytetit” pikërisht Pinokun, që talentin më të madh e tregon kur çnderon futbollin më shumë se kur e nderon atë... (Panorama Sport, 02.06.2017).

- **Funksion** i shprehur nëpërmjet **përcaktorit me përshtatje:**

- **Funksion** i shprehur me **fjali të nënrenditura përcaktore:**

...një qeveri (1) *vepruese* në realen tonë, (2) *që e kemi në vend, që e avancon gjendjen në rend dhe ligj, që e avancon menjëherë gjendjen në ekonomi*, duke u bazuar në sipërmarrësit tanë... (Shekulli, 09.06.2017).

- **Mënyrë** e shprehur nëpërmjet **kundrinorëve të zhdrejtë me parafjalë:**

I rritur ndërmjet revolucionit teknologjik dhe fermentit politik dhe kulturor që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh me zhgënjim ndaj kompanive të Internetit: një botë “liberale” në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste. (ATSH, 02.05.2017).

- **Shpejtësi** e shprehur nëpërmjet **rrethanorit të mënyrës:**

...një qeveri vepruese në realen tonë, që e kemi në vend, që e avancon gjendjen në rend dhe ligj, që e avancon *menjëherë* gjendjen në ekonomi, duke u bazuar në sipërmarrësit tanë... (Shekulli, 09.06.2017).

- **Vijimësi** e shprehur me **fjali bashkërenditëse shtuese**:

Kisha është ndërtuar gjatë periudhës së kalimit nga shek. XI në shek. XII dhe më vonë ky objekt kaq unik në vendin tonë u është nënshtruar disa ndërhyrjeve të reja restauruese... (ATSH, 03.06.2017).

PENGESAT / SFIDAT:

- **Kritikë** e shprehur nëpërmjet **rrethanorit të mënyrës**:
- **Problem** i shprehur me **fjali të nënrenditur kundrinore**:

I rritur ndërmjet revolucionit teknologjik dhe fermentit politik dhe kulturor që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh *me zhgënjim* ndaj kompanive të Internetit: *një botë "liberale" në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste*. (ATSH, 02.05.2017).

- **Sarkazëm** e shprehur me **fjali të nënrenditur shkakore, së cilës i nënrenditet një fjali e varur kundrinore**:
- **Tendencë** e shprehur me **fjali të nënrenditur krahasore**:

Kujtoni ditët pas Europeanit, kur disa qytete u grindën mes tyre, *sepse donin të ishin të parët* për ta graduar "Nderi i qytetit" pikërisht Pinokun, që talentin më të madh e tregon kur çnderon futbollin *më shumë se kur e nderon atë*... (Panorama Sport, 02.06.2017).

- **Ndërhyrje** e shprehur nëpërmjet **kundrinorit të zhdrejtë**:

Kisha është ndërtuar gjatë periudhës së kalimit nga shek. XI në shek. XII dhe më vonë ky objekt kaq unik në vendin tonë u është nënshtruar disa ndërhyrjeve të reja restauruese... (ATSH, 03.06.2017).

- **Bllokim** i shprehur nëpërmjet **kallëzuesit**:

Kreditorët, me Gjermaninë nga njëra anë dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar nga ana tjetër, deri tani *kanë bllokuar* lëvrimin e kështit të fundit, në mes të një marrëveshjeje nëse duhet apo jo të lehtësohet shlyerja e borxheve për Greqinë në një nivel të qëndrueshëm. (Shqiptarja.com, 10.06.2017).

- **Konflikt** i shprehur me **fjali të nënrenditur kohore (nuancë përcaktore)**:
- **Goditje** e shprehur me **fjali të nënrenditur përcaktore**:
- **Viktima** e shprehur nëpërmjet **kundrinorit të drejtë**:

Kujtoni ditët pas Europeanit, *kur disa qytete u grindën mes tyre*, sepse donin të ishin të parët për ta graduar "Nderi i qytetit" pikërisht Pinokun, që talentin më të madh e tregon *kur çnderon futbollin* më shumë se kur e nderon atë... (Panorama Sport, 02.06.2017).

- **Humbje** e shprehur nëpërmjet **kallëzuesit**:

Ata *humbën* mbi dhjetë vende në Parlament, krahasuar me parlamentin paraardhës, ku, mes humbësve, ishin edhe pesë ministra të qeverisë May, të cilët nuk arritën të mbanin vendin e tyre në Parlament. (Shekulli, 09.06.17).

KRIJIMTARIA / JETA E RE:

- **Entitet** i shprehur nëpërmjet **kryefjalës**:
- **Përbërësit** shprehur nëpërmjet **kundrinorëve të zhdrejtë me parafjalë**:

Kreditorët, me Gjermaninë nga njëra anë dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar nga ana tjetër, deri tani kanë bllokuar lëvrimin e kështit të fundit, në mes të një marrëveshjeje nëse duhet apo jo të lehtësohet shlyerja e borxheve për Greqinë në një nivel të qëndrueshëm. (Shqiptarja.com, 10.06.2017).

- **Themel** i shprehur nëpërmjet **kallëzuesit**:
- **Themel** i shprehur nëpërmjet **kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë**:

...një qeveri vepruese në realen tonë, që e kemi në vend, që e avancon gjendjen në rend dhe ligj, që e avancon menjëherë gjendjen në ekonomi, duke u bazuar në sipërmarrësit tanë... (Shekulli, 09.06.2017).

- **Teknologji** e shprehur nëpërmjet **përcaktorit me përshtatje**:
- **Krijimtari** e shprehur nëpërmjet **kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë**:

I rritur *ndërmjet* revolucionit *teknologjik* dhe *fermentit* politik dhe kulturor që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh me zhgënjim ndaj kompanive të Internetit: një botë “liberale” në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste. (ATSH, 02.05.2017).

- **Masë** e shprehur nëpërmjet **kryefjalës (tog)**:
- **Masë** e shprehur nëpërmjet **rrethanorit të mënyrës (tog)**:

Kreditorët, me Gjermaninë nga njëra anë dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar nga ana tjetër, deri tani kanë bllokuar lëvrimin e kështit të fundit, në mes të një marrëveshjeje nëse duhet apo jo të lehtësohet shlyerja e borxheve për Greqinë në një nivel të qëndrueshëm. (Shqiptarja.com, 10.06.2017).

- **Masë** e shprehur nëpërmjet **rrethanorit të sasisë**:
- **Bazë** e shprehur nëpërmjet **kundrinorit të drejtë**:

Ata *humbën mbi dhjetë vende* në Parlament, krahasuar me parlamentin paraardhës, ku, mes humbësve, ishin edhe *pesë ministra* të qeverisë May,

të cilët nuk arritën të mbanin vendin e tyre në Parlament. (Shekulli, 09.06.17).

- **Origjinalitet** i shprehur nëpërmjet **kryefjalës**:
- **Origjinalitet** i shprehur nëpërmjet **kallëzuesit emëror**:
- **Origjinalitet** i shprehur nëpërmjet **rrethanorit të mënyrës**:

“Zero yje” është emri i hotelit me zero mure, që të jep mundësinë që të shikosh malet e qiellin pa asnjë lloj pengese. (Shqiptarja.com, 08.06.2017).

- **Objekt (kulti)** i shprehur nëpërmjet **kryefjalës**:
- **Ndërtim** i shprehur nëpërmjet **kallëzuesit**:
- **Restaurim** i shprehur nëpërmjet **përcaktorit me drejtim**:

Kisha është ndërtuar gjatë periudhës së kalimit nga shek. XI në shek. XII dhe më vonë ky objekt kaq unik në vendin tonë u është nënshtruar disa ndërhyrjeve të reja restauruese... (ATSH, 03.06.2017).

METODA STUDIMORE:

- **Fokusuesi** i shprehur nëpërmjet **kryefjalës**:
- **Orientim** i shprehur nëpërmjet **kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë**:
- **Ekspertim** i shprehur me **fjali të nënrenditur kundrinore**:

I rritur ndërmjet revolucionit teknologjik dhe fermentit politik dhe kulturor që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, *Taplin* sheh me zhgënjim ndaj kompanive të Internetit: *një botë “liberale” në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste. (ATSH, 02.05.2017).*

- **Orientim** i shprehur nëpërmjet **kallëzuesit**:
- **Fokusim** i shprehur nëpërmjet pesë **kundrinorëve të drejtë**:

Kujtoni ditët pas Europeanit, kur disa qytete u grindën mes tyre, sepse donin të ishin të parët për ta graduuar “Nderi i qytetit” pikërisht Pinokun, që talentin më të madh e tregon kur çnderon futbollin më shumë se kur e nderon atë... (Panorama Sport, 02.06.2017).

- **Orientim** i shprehur me **fjali të nënrenditur kryefjalore**:

Kreditorët, me Gjermaninë nga njëra anë dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar nga ana tjetër, deri tani kanë bllokuar lëvrimin e kështit të fundit, në mes të një marrëveshjeje nëse duhet apo jo të *lehtësohet shlyerja e borxheve për Greqinë në një nivel të qëndrueshëm. (Shqiptarja.com, 10.06.2017).*

- **Orientim** i shprehur me **fjali të nënrenditur përcaktore**:
- **Orientim** i shprehur me **fjali të nënrenditur qëllimore**:

“Zero yje” është emri i hotelit me zero mure, që të jep mundësinë që të shikosh malet e qiellin pa asnjë lloj pengese. (Shqiptarja.com, 08.06.2017).

- **Fokusim** i shprehur nëpërmjet **kryefjalëve**:

Para togave të zeza, të katër dëshmitarët pohuan faktin se ditën kur ka ndodhur rrëmbimi dhe vrasja e Gaz Çollakut, i ndjeri Ervin Dalipaj, i akuzuar për këtë ngjarje, ishte me ta në një lokal në Tiranë. (Shekulli, 09.06.2017).

- **Fokusim** i shprehur nëpërmjet **kallëzuesit**:

“Zero yje” është emri i hotelit me zero mure, që të jep mundësinë që të shikosh malet e qiellin pa asnjë lloj pengese. (Shqiptarja.com, 08.06.2017).

- **Fokusim** i shprehur nëpërmjet **rrethanorit të vendit**:

...një qeveri vepruese në realen tonë, që e kemi në vend, që e avancon gjendjen në rend dhe ligj, që e avancon menjëherë gjendjen në ekonomi, duke u bazuar në sipërmarrësit tanë... (Shekulli, 09.06.2017).

- **Krahasim** i shprehur nëpërmjet **raporteve kohore**:

Ata humbën mbi dhjetë vende në Parlament, krahasuar me parlamentin paraardhës, ku, mes humbësve, ishin edhe pesë ministra të qeverisë May, të cilët nuk arritën të mbanin vendin e tyre në Parlament. (Shekulli, 09.06.17).

- **Shqyrtim** i shprehur nëpërmjet **kallëzuesit**:

I rritur ndërmjet revolucionit teknologjik dhe fermentit politik dhe kulturor që ka kaluar për disa dekada Kalifornia, Taplin sheh me zhgënjim ndaj kompanive të Internetit: një botë “liberale” në sytë e shumicës, por që për të nuk është aspak progresiste. (ATSH, 02.05.2017).

Kreditorët, me Gjermaninë nga njëra anë dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar nga ana tjetër, deri tani kanë bllokuar lëvrimin e kështit të fundit, në mes të një marrëveshjeje nëse duhet apo jo të lehtësohet shlyerja e borxheve për Greqinë në një nivel të qëndrueshëm. (Shqiptarja.com, 10.06.2017).

VLERAT:

- **Dëshmi** e shprehur nëpërmjet **kryefjalës**:

- **Dëshmi** e shprehur nëpërmjet **kallëzuesit**:

Para togave të zeza, të katër dëshmitarët pohuan faktin se ditën kur ka ndodhur rrëmbimi dhe vrasja e Gaz Çollakut, i ndjeri Ervin Dalipaj, i akuzuar për këtë ngjarje, ishte me ta në një lokal në Tiranë. (Shekulli, 09.06.2017).

- **Parashtrim** i shprehur me **fjali të nënrenditur kundrinore**:

- **Përfshirje** e shprehur me **fjali të nënrenditur përcaktore**:

Para togave të zeza, të katër dëshmitarët pohuan faktin se ditën kur ka ndodhur rrëmbimi dhe vrasja e Gaz Çollakut, i ndjeri Ervin Dalipaj, i akuzuar për këtë ngjarje, ishte me ta në një lokal në Tiranë. (Shekulli, 09.06.2017).

- **Veçanti** e shprehur nëpërmjet **rrethanorit të mënyrës:**

Kisha është ndërtuar gjatë periudhës së kalimit nga shek. XI në shek. XII dhe më vonë ky objekt *kaq unik* në vendin tonë u është nënshtruar disa ndërhyrjeve të reja restauruese... (ATSH, 03.06.2017).

- **Thelbësore** e shprehur me **fjali të nënrenditur përcaktore:**

Kujtoni ditët pas Europeanit, kur disa qytete u grindën mes tyre, sepse donin të ishin të parët për ta graduar “Nderi i qytetit” pikërisht Pinokun, *që talentin më të madh e tregon* kur çnderon futbollin më shumë se kur e nderon atë... (Panorama Sport, 02.06.2017).

- **Përfshirje** e shprehur nëpërmjet raporteve **kryefjalore:**

- **Shtjellim** i shprehur nëpërmjet **fjalisë së nënrenditur përcaktore:**

Ata humbën mbi dhjetë vende në Parlament, krahasuar me parlamentin paraardhës, ku, mes humbësve, ishin edhe *pesë ministra* të qeverisë May, *të cilët nuk arritën të mbanin vendin e tyre në Parlament*. (Shekulli, 09.06.17).

- **Vizion** i shprehur nëpërmjet **kryefjalës:**

...*një qeveri* vepruese në realen tonë, që e kemi në vend, që e avancon gjendjen në rend dhe ligj, që e avancon menjëherë gjendjen në ekonomi, duke u bazuar në sipërmarrësit tanë... (Shekulli, 09.06.2017).

Këto koncepte të hulumtuara nga jeta e përditshme nuk janë thjesht vetëm disa indikacione për të dhënë disa ngacmime në kushtet e një kumtese. Secili prej tyre, i pasuar edhe nga treguesit sintaksorë përkatës, është e mundur të vendoset në një hierarki vlerash shkencore në ndihmë jo vetëm të hartimit të gramatikave apo të përmirësimit të atyre ekzistueseve, por edhe në ndihmë të çdo asistence të specializuar që nevojitet për çështje të komunikimit shoqëror në tërësi, pavarësisht vendit, kohës, teknologjive, institucioneve shoqërore, ku individit të ndihet i integruar si pjesë e një komuniteti ndërveprues.

